REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

RAPORT KOMBËTAR 2017

Perceptimi i mësuesve dhe prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

IZHA
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

RAPORT KOMBËTAR
2017

Perceptimi i mësuesve dhe prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

GRUPI I PUNËS:

Zamira GJINI	Drejtore e DAPU, MAS
Gerti JANAQI	Drejtori i IZHA
Esion ZGJANA	IZHA
Albana MARKJA	IZHA
Evis MASTORI	IZHA
Dorina RAPTI	IZHA
Marina TOPULLI	IZHA

REDAKTOR LETRAR:

Erida KOLECI	IZHA
Rozeta HYSENI	IZHA

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES 3

LISTA E TABELAVE 5

LISTA E GRAFIKËVE 6

PËRMBLEDHJE 10

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT 13

METODOLOGJIA DHE INSTRUMENTET E PËRDORUR 15

REZULTATET E MËSUESVE 17

4.1 Analiza përshkruese 18

4.2 Analiza për çdo pohim në shkallë kombëtare dhe në nivel DAR-i 25

4.2.1 Pohimi: Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme 25

4.2.2 Pohimi: Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve 28

4.2.3 Pohimi: Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve 31

4.2.4 Pohimi: Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve 34

4.2.5 Pohimi: Identifikimi i personalizuar i nevojave për secilin mësues ka lehtësuar orientimin e mësuesve për zhvillimin profesional të tyre 37

4.2.6 Pohimi: Ndryshimet e kryera në arsim e kanë bërë shkollën më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse 40

4.2.7 Pohimi: Numri i reduktuar i alternativave të teksteve mësimore ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre 43

4.2.8 Pohimi: Tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies 46

4.2.9 Pohimi: Ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete 49

4.2.10 Pohimi: Reformat e ndërmarra në drejtim të nismës “Shkolla qendër komunitare” kanë mundësuar partneritet më të mirë shkollë-familje- komunitet 52

4.2.11 Pohimi: Portali “Mësues për Shqipërinë” mundëson punësim të bazuar në meritë dhe në arritje 55

4.2.12 Pohimi: Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit 58

4.2.13 Pohimi: Nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor 61

4.2.14 Pohimi: Rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit 64

REZULTATET E PRINDËRVE 67
5.1 Analiza përshkruese 68
5.2 Analiza për çdo pohim në shkallë kombëtare dhe në nivel DAR-i 75
5.2.1 Pohimi: Programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë. 75
5.2.2 Pohimi: Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije 78
5.2.3 Pohimi: Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur 81
5.2.4 Pohimi: Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim 84
5.2.5 Pohimi: Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës. 87
5.2.6 Pohimi: Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit 90
5.2.7 Pohimi: Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët 93
5.2.8 Pohimi: Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm 96

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 99
6.1 Konkluzione 100
6.2 Rekomandime 101

ANEKSET 103
7.1 ANEKSI 1 104
7.2 ANEKSI 2 106

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Cronbach's Alpha për instrumentin e mësuesve	18
Tabela 2	Të dhënat përshkruese për çdo DAR	20
Tabela 3	Të dhënat përshkruese për çdo pohim	22
Tabela 4	Cronbach's Alpha për instrumentin e prindërve	68
Tabela 5	Të dhënat përshkruese për çdo DAR	71
Tabela 6	Të dhënat përshkruese për çdo pohim	73

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1	Shpërndarja e kampionit të mësuesve për çdo DAR	18
Grafiku 2	Gjinia e mësuesve	19
Grafiku 3	Shpërndarja sipas llojit të arsimit ku japin mësim	19
Grafiku 4	Mesatarja në nivel DAR-i për instrumentin e mësuesve në total	21
Grafiku 5	Vlerat mesatare për secilin pohim	24
Grafiku 6	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme”	25
Grafiku 7	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme”	26
Grafiku 8	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme”	27
Grafiku 9	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve”	28
Grafiku 10	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve”	29
Grafiku 11	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve”	30
Grafiku 12	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve”	31
Grafiku 13	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve”	32
Grafiku 14	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve”	33
Grafiku 15	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve”	34
Grafiku 16	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve”	35
Grafiku 17	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve”	36
Grafiku 18	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Identifikimi i personalizuar i nevojave për secilin mësues ka lehtësuar orientimin e mësuesve për zhvillimin profesional të tyre”	37

Grafiku 19	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Identifikimi i personalizuar i nevojave për secilin mësues ka lehtësuar orientimin e mësuesve për zhvillimin profesional të tyre”	38
Grafiku 20	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Identifikimi i personalizuar i nevojave për secilin mësues ka lehtësuar orientimin e mësuesve për zhvillimin profesional të tyre”	39
Grafiku 21	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Ndryshimet e kryera në arsim e kanë bërë shkollën më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse”	40
Grafiku 22	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Ndryshimet e kryera në arsim e kanë bërë shkollën më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse”	41
Grafiku 23	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Ndryshimet e kryera në arsim e kanë bërë shkollën më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse”	42
Grafiku 24	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Numri i reduktuar i alternativave të teksteve mësimore ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre”	43
Grafiku 25	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Numri i reduktuar i alternativave të teksteve mësimore ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre”	44
Grafiku 26	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Numri i reduktuar i alternativave të teksteve mësimore ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre”	45
Grafiku 27	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies”	46
Grafiku 28	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies”	47
Grafiku 29	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies”	48
Grafiku 30	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete”	49
Grafiku 31	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin R pohimin “Ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete”	50
Grafiku 32	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete”	51
Grafiku 33	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Reformat e ndërmarra në drejtim të nismës “Shkolla qendër komunitare” kanë mundësuar partneritet më të mirë shkollë-familje- komunitet”	52
Grafiku 34	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Reformat e ndërmarra në drejtim të nismës “Shkolla qendër komunitare” kanë mundësuar partneritet më të mirë shkollë-familje- komunitet”	53
Grafiku 35	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Reformat e ndërmarra në drejtim të nismës “Shkolla qendër komunitare” kanë mundësuar partneritet më të mirë shkollë-familje- komunitet”	54

Grafiku 36	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Portali “Mësues për Shqipërinë” mundëson punësim të bazuar në meritë dhe në arritje”	55
Grafiku 37	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Portali “Mësues për Shqipërinë” mundëson punësim të bazuar në meritë dhe në arritje”	56
Grafiku 38	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Portali “Mësues për Shqipërinë” mundëson punësim të bazuar në meritë dhe në arritje”	57
Grafiku 39	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit”	58
Grafiku 40	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit”	59
Grafiku 41	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit”	60
Grafiku 42	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor”	61
Grafiku 43	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor”	62
Grafiku 44	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor”	63
Grafiku 45	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit”	64
Grafiku 46	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit”	65
Grafiku 47	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit”	66
Grafiku 48	Shpërndarja e kampionit të prindërve për çdo DAR	68
Grafiku 49	Gjinia e prindërve	69
Grafiku 50	Niveli i edukimit të prindërve	69
Grafiku 51	Statusi i punësimit të prindërve	70
Grafiku 52	Mesatarja në nivel DAR-i për instrumentin e mësuesve në total	72
Grafiku 53	Të dhënat përshkruese për çdo pohim	74
Grafiku 54	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t’i përdorur njohuritë në praktikë”	75

Grafiku 55	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t’i përdorur njohuritë në praktikë”	76
Grafiku 56	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t’i përdorur njohuritë në praktikë”	77
Grafiku 57	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Kurrikula e re i përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije”	78
Grafiku 58	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e re i përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije”	79
Grafiku 59	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e re i përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije”	80
Grafiku 60	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur”	81
Grafiku 61	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur	82
Grafiku 62	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur”	83
Grafiku 63	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin“Shkolla dhe mësuesit iu kanë informuar për reformat në arsim”	84
Grafiku 64	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Shkolla dhe mësuesit iu kanë informuar për reformat në arsim”	85
Grafiku 65	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Shkolla dhe mësuesit iu kanë informuar për reformat në arsim”	86
Grafiku 66	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës”	87
Grafiku 67	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës”	88
Grafiku 68	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës”	89
Grafiku 69	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit”	90
Grafiku 70	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit”	91
Grafiku 71	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit”	92
Grafiku 72	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët”	93
Grafiku 73	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët”	94
Grafiku 74	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët”	95
Grafiku 75	Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin “Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm”	96
Grafiku 76	Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin “Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm”	97
Grafiku 77	Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin “Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm”	98

PËRMBLEDHJE

Raporti kombëtar “Perceptimi i mësuesve dhe prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” pasqyron gjetjet e një studimi kombëtar që MAS-i ndërmori gjatë periudhës dhjetor 2016- shkurt 2017 me **mësues dhe prindër.**

Prej shtatorit të 2013-s MAS-i ka kthyer në traditë matjen e perceptimit të punonjësve arsimorë, nxënësve, prindërve apo aktorëve të tjerë të interesuar në lidhje me nisma të rëndësishme që janë pjese e reformës së arsimit parauniversitar.

Rezultatet e studimit “Perceptimi i mësuesve dhe prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” do t’u shërbejnë MAS-it, institucioneve të varësisë, DAR/ZA-ve, vetë shkollës për të hartuar strategji dhe plane veprimi konkrete për përmirësimin dhe për zhvillimin e mëtejshëm të reformës së arsimit parauniversitar.

Gjetjet e këtij studimi janë bazuar në rezultatet e arritura nga gjithë popullata që mori pjesë në studim, rreth **27561 mësues dhe 18966 prindër.**

Ndër gjetjet kryesore mund të përmendim:

a) **73,1% e mësuesve** (37,5% janë plotësisht dakord dhe 35,68 dakord) pohojnë se kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve.

b) **70% e mësuesve** (33,4 janë plotësisht dakord dhe 36,68% dakord) pohojnë se reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve.

c) **74,8% e mësuesve** (32,59 janë plotësisht dakord dhe 42,26% dakord) shprehen se identifikimi i personalizuar i nevojave për trajnim i ka ndihmuar në orientimin personal për zhvillim profesional.

d) **81,7% e mësuesve** (44,8% janë plotësisht dakord dhe 36,9% dakord) **pohojnë se si pasojë e reformës në arsimin parauniversitar shkolla është bërë më miqësore dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.**

e) **84% e mësuesve** (48,2 % janë plotësisht dakord dhe 36,2% dakord) besojnë se numri i ulët i alternativave të teksteve e ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre.

f) **75,89% e mësuesve** (34,39% janë plotësisht dakord dhe 41,5% janë dakord) pohojnë se tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies.

g) **71% e mësuesve** (37,6% janë plotësisht dakord dhe 33,4% dakord) shprehen se ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete.

h) **75,6% e mësuesve** (45,32% janë plotësisht dakord dhe 30,03% dakord) besojnë se portali i punësimit " Mësues për Shqipërinë" mundëson punësimin e bazuar në meritë e arritje.

i) **84,7% e mësuesve** (43,81% janë plotësisht dakord dhe 40,9% dakord) shprehen se nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor.

j) **85,9% e mësuesve** (53,6% janë plotësisht dakord dhe 32,3 % dakord) pohojnë se rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit.

k) **74,1% e prindërve** (34,7% janë plotësisht dakord dhe 39,4% dakord) besojnë se programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë.

l) **70% e prindërve** (34,57% janë plotësisht dakord dhe 36,1% dakord) pohojnë se kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur.

m) **82,6% e prindërve** (55,1% janë plotësisht dakord dhe 27,55% dakord) pohojnë se janë informuar nga mësuesit për reformat e ndërmarra në arsimin parauniversitar.

n) **81% e prindërve** (51,24% janë plotësisht dakord dhe 29,7 % dakord) shprehen se shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës.

o) **79,4% e prindërve** (44,6% janë plotësisht dakord dhe 34,8% dakord) pohojnë se tekstet mësimore u vijnë në ndihmë fëmijëve të tyre në procesin e të nxënit.

p) **86,3% e prindërve** (59,9% janë plotësisht dakord dhe 26,6% dakord) pohojnë se pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i kryerjes së studimit kombëtar mbi "Perceptimin e mësuesve dhe prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" është i lidhur ngushtësisht me përvojën që MAS-i ka konsoliduar për t'u konsultuar me punonjësit arsimorë dhe prindërit në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit që duhet t'u ofrohet mësuesve dhe fëmijëve në arsimin parauniversitar.

Që prej shatorit të vitit 2013, Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë në arsimin parauniversitar. Reforma e arsimit parauniversitar merr parasysh arritjet, dobësitë dhe sfidat që përball arsimi parauniversitar shqiptar. Përmes kësaj reforme synohet që SAPU-ja t'i sigurojë çdo nxënësje/nxënësi plotësimin e të drejtës për arsimim cilësor dhe mundësi të barabarta për t'u arsimuar si dhe të krijojë kushtet që nxënëset/nxënësit të ndërtojnë/të zbatojnë njohuri shkencore, teknike, sociale, historike, artistike dhe kompetenca kyçe, vlera dhe qëndrime për jetë të shëndetshme. Arsimi parauniversitar duhet të mundësojë që nxënëset dhe nxënësit tanë të ndërtojnë kompetencën për të nxënë gjatë gjithë jetës. Nga ana tjetër, reforma arsimore duhet të përafrojë sa më mirë që të jetë e mundur kushtet e të nxënit në institucionet arsimore parauniversitare. Përparësi e saj duhet të jetë një sistem arsimor i njësuar dhe i krahasueshëm me sistemet arsimore rajonale dhe ato evropiane.

Objektivat e këtij studimi përmblidhen si më poshtë:

- Mbledhja e perceptimit të çdo mësuesi në mënyrë individuale mbi cilësinë e implementimit të reformës së arsimit parauniversitar;
- Mbledhja e perceptimit të prindërve mbi cilësinë e implementimit të reformës së arsimit parauniversitar;
- Prezantimi i rezultateve për secilin nga pohimet e matura si te mësuesit dhe prindërit;
- Prezantimi i rekomandimeve duke u bazuar në gjetjet e këtij procesi.

METODOLOGJIA DHE INSTRUMENTET E PËRDORUR

Metodologjia e studimit është hartuar e tillë që të arrijë në përfundime e të krahasojë opinione e mendime të të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë. Studimi është i tipit deskriptiv. Të dhënat primare vijnë nga target grupet e përfshira përmes pyetësorëve. Studimi u realizua në shkallë kombëtare

Pjesëmarrësit në këtë studim janë mësues në sistemin arsimor parauniversitar dhe prindër të nxënësve. Kampioni i këtij studimi përbëhet nga 27561 mësues në sistemin parauniversitar në të gjithë Shqipërinë dhe 18996. Përsa i përket shpërndarjes së kampionit të mësuesve shikojmë se gjinia femër zë 74% të kampionit, ndërsa gjinia mashkull rrjedhimisht ka përfaqësimin 25,8%. Gjithashtu kemi dhe një pjesë të vogël të kampionit (0,2%) të cilët nuk i janë përgjigjur pohimit rreth përkatësisë gjinore. Përsa i përket shpërndarjes së gjinisë së kampionit të prindërve, numrit më të madh të gjinisë pjesëmarrëse në këtë studim e zë ajo femër (57,9%), ndërsa gjinia mashkull rrjedhimisht ka përfaqësimin më të ulët (42%). Gjithashtu kemi dhe një pjesë të vogël të kampionit (0,1%) të cilët nuk i janë përgjigjur pohimit rreth përkatësisë gjinore.

Mësuesit dhe prindërit që kanë marrë pjesë në këtë studim janë të informuar rreth qëllimit të këtij studimi. Të gjitha të dhënat e marra nga mësuesit dhe prindërit për këtë studim janë të vlefshme, pasi individët janë të informuar rreth sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri.

Për realizimin e studimit janë përdorur dy instrumenta.

Instrumenti i parë është një pyetësor i cili është i ndërtuar nga 14 pohime (Aneksi 1) të cilat masin të gjithë komponentët ku shtrihet reforma në arsimin parauniversitar. Ky pyetësor është aplikuar tek të gjithë mësuesit të cilët janë pjesë e sistemit arsimor parauniversitar. Ky instrument ka për synim që të marrë sa më shumë informacion mbi impaktin e reformës në sistemin parauniversitar sipas gjykimeve dhe qëndrimeve të mësuesve. Pohimet janë të ndërtuar sipas shkallës likert, me vlerësim nga 1-5, ku 1=aspak dakord dhe 5=plotësisht dakord.

Instrumenti i dytë është një pyetësor i cili është i ndërtuar nga 8 pohime (Aneksi 2) të cilat masin të gjithë komponentët ku shtrihet reforma në arsimin parauniversitar. Ky pyetësor është aplikuar tek prindër të cilët kanë fëmijët e tyre pjesë të sistemit arsimor parauniversitar. Ky instrument ka për synim që të marrë sa më shumë informacion mbi impaktin e reformës në sistemin parauniversitar sipas gjykimeve dhe qëndrimeve të prindërve. Pohimet janë të ndërtuar sipas shkallës likert, me vlerësim nga 1-5, ku 1=aspak dakord dhe 5=plotësisht dakord.

Analiza e të dhënave konsiston te jetë kryer në këto drejtime:

- Analiza e të dhënave të mbledhura nga pyetësorët e aplikuar tek prindër dhe mësues.
- Përpunimi i të dhënave është bërë me programin kompjuterik SPSS.
- Përpunimi i të dhënave është bërë me programin kompjuterik Exel të paketës Microsoft Office.
- Paraqitja e të dhënave u bë me anë të grafikëve, vlerave mesatare, tabelave përshkruese dhe përqindjeve.

Gjatë aplikimit të pyetësorëve u morën parasysh çështë etike duke siguruar ruajtjen e anonimatit, konfidecialitetin dhe trajtimin e drejtë tek pjesëmarrësit. Për këtë pjesëmarrësit:

- U informuan për qëllimet e studimit.
- U lanë të lirë të zgjidhnin vullnetarisht nëse donin të merrnin pjesë në studim.
- U informuan mbi mënyrën si do të dilnin rezultatet e studimit.
- U informuan se mund të tërhiqeshin nga studimi nëse nuk ndiheshin komod për ndonjë arsye.

REZULTATET E MËSUESVE

4.1 Analiza përshkruese

Për matjen e besueshmërisë së instrumentit të përdorur për mësuesit është përdorur alpha e choronbach[1], koeficient që shërben për matjen e besueshmërisë së testeve psikometrike. Nga analiza e bërë nëpërmjet koeficientit alpha të choronbach's për të matur besueshmërinë e instrumentit të përdorur për mësuesit, dalim në rezultatet se kjo pjesë e instrumentit ka një besueshmëri të shkëlqyer (14 pohime, α = .908).

Statistikat e besueshmërisë

Cronbach's Alpha	N of Items
,908	14

Tabela 1. Cronbach's Alpha për instrumentin e mësuesve

Në grafikun 1 është për paraqitja e shpërndarjes së kampionit të mësuesve që kanë marrë pjesë në këtë studim. Nga gjetjet rezulton se DAR-i me numrin më të lartë të mësuesve që kanë marrë pjesë është ai i Fierit (12,9%), pasuar nga DAR-i i Tirana Qark (12,3 %) dhe DAR Elbasan (12,3 %). Ndërsa DAR-i me numrin më të ulët të mësuesve është ai i Kukësit (4%) dhe DAR-i i Dibrës (3,4%).



Grafiku 1. Shpërndarja e kampionit të mësuesve për çdo DAR

1 Vlerat e Alpha së Cronbach: 0.5 > α = E papranueshme; 0.6 > α ≥ 0.5 = E dobët; 0.7 > α ≥ 0.6 = E diskutueshme; 0.8 > α ≥ 0.7= E pranueshme0.9 > α ≥ 0.8 = Shumë e mirë; α ≥ 0.9 = E Shkëlqyer.



Grafiku 2. Gjinia e mësuesve

Përsa i përket shpërndarjes së gjinisë (grafiku 2) së kampionit të mësuesve shikojmë një diferencë të ndjeshme midis gjinisë femër dhe asaj mashkull. Numrit më të madh të gjinisë pjesëmarrëse në këtë studim e zë ajo femër (74%), ndërsa gjinia mashkull rrjedhimisht ka përfaqësimin më të ulët (25,8). gjithashtu kemi dhe një pjesë të vogël të kampionit (0,2%) të cilët nuk i janë përgjigjur pohimit rreth përkatësisë gjinore.

Në paraqitjen grafike të mëposhtme (grafiku 3) janë gjetjet rreth shpërndarjes së kampionit të mësuesve sipas llojit të arsimit ku japin mësim. Siç edhe shikohen në grafik, numrin më të lartë e zë kampioni i mësuesve të cilën japin mësim në AMU (45,6%), pasuar nga AF (28,8%), AML (20,3%) dhe APSH (4,1%). Gjithashtu nga gjetjet rezultoi se kemi edhe një numër të caktuar mësuesish që ushtrojnë profesionin e tyre njëkohësit në dy lloje arsimi ku AF+AMU (0,9%) dhe AMU+AML (0,3%).



Grafiku 3. Shpërndarja sipas llojit të arsimit ku japin mësim

Nr.	DAR	N	Min.	Max.	Mesatarja	Devijimi Standard[2]
1	**Berat**	1599	14,00	70,00	62,1989	7,44831
2	**Dibër**	901	14,00	70,00	55,9967	8,91360
3	**Durrës**	1563	14,00	70,00	55,9002	10,28208
4	**Elbasan**	2980	18,00	70,00	57,5977	9,40004
5	**Fier**	3271	14,00	70,00	58,3115	9,61458
6	**Gjirokastër**	832	19,00	70,00	58,0709	9,26887
7	**Korçë**	2932	19,00	70,00	59,0065	7,87489
8	**Kukës**	1096	14,00	70,00	56,3978	9,85162
9	**Lezhë**	1421	0,00	70,00	57,7748	9,23519
10	**Shkodër**	2226	14,00	70,00	55,4726	10,01529
11	**Tirana Qytet**	2771	14	70	56,0332	10,17594
12	**Tirana Qark**	3227	14,00	70,00	56,7403	8,83801
13	**Vlorë**	1343	15,00	70,00	56,4267	9,68130

Tabela 2. Të dhënat përshkruese për çdo DAR

Tabela 2 përmban të dhënat përshkruese në nivel DAR-i për instrumentin e përdorur, ku përfshihet numri i kampionit për çdo DAR, minimumi i deklarimeve, maksimumi i deklarimeve, mesatarja në nivel DAR-i dhe devijimi standard. Për të parë se kush janë DAR-et më nivelin më të lartë apo me nivelin më të ulët për instrumentin e mësuesve është bërë paraqitja grafike e mesatareve të tyre (grafiku 4). Nga informacioni i marrë nga grafiku 4, shohim se DAR-i me mesataren më të lartë është ai i Beratit me një mesatare 62,2 ndërkohë që mesatarja në nivel kombëtar është 56,4. **Nga kjo dalim në përfundimin se perceptimin e mësuesve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë është më pozitiv në DAR Berat.** Nga grafiku vëmë re se vlerën më të ulët mesatare e ka DAR Shkodër me 5,5, ku mund të themi se **perceptimin e mësuesve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisëështë më i dobët në DAR Shkodër.**

Numri i DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 5 (grafiku 4), përkatësisht DAR-et: Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Lezhë dhe Tirana Qark. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 5, ku përmendim DAR-et: Durrës, Dibër, Shkodër, Tirana Qytet dhe Vlorë. DAR-i Kukës ka një mesatare 56,64, mesatare kjo e barabartë me mesataren në nivel kombëtar.

2 **Devijimi Standard** është një tregues i ndryshueshmërisë i cili tregon sesi janë shpërndarë rezultatet rreth mesatares aritmetike. Llogaritet mbi bazën e të gjithë rezultateve dhe jo vetëm mbi bazën e rezultateve më të skajshme.



Grafiku 4. Mesatarja në nivel DAR-i për instrumentin e mësuesve në total

Nr.	Pohimi	N	Min.	Max.	Mesatarja	Devijimi Standard	Cronbach's Alpha nëse pohimi fshihet
1	Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme	27509	,00	5,00	4,0541	,93865	,899
2	Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve	27494	,00	5,00	3,9823	,93294	,898
3	Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve	27514	,00	5,00	3,9456	1,09147	,901
4	Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve	27492	,00	5,00	3,8533	1,09322	,900
5	Identifikimi i personalizuar i nevojave për secilin mësues ka lehtësuar orientimin e mësuesve për zhvillimin profesional të tyre	27475	,00	5,00	3,9583	,98284	,899
6	Ndryshimet e kryera në arsim e kanë bërë shkollën më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse	27497	,00	5,00	4,1792	,94231	,898
7	Numri i reduktuar i alternativave të teksteve mësimore ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre	27477	,00	5,00	4,2379	,94173	,901
8	Tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies	27432	,00	5,00	3,9727	1,01495	,898
9	Ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete	26689	,00	5,00	3,8958	1,20659	,906
10	Reformat e ndërmarra në drejtim të nismës "Shkolla qendër komunitare" kanë mundësuar partneritet më të mirë shkollë-familje- komunitet	27358	,00	5,00	4,0907	1,12421	,905
11	Portali "Mësues për Shqipërinë" mundëson punësim të bazuar në meritë dhe në arritje	27387	,00	5,00	4,0485	1,12860	,901
12	Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit	27446	,00	5,00	4,5994	,75312	,907
13	Nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor	27166	,00	5,00	4,2236	,86678	,902
14	Rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit	27175	,00	5,00	4,3365	,87874	,903

Tabela 3. Të dhënat përshkruese për çdo pohim

Tabela 3 përmban të dhënat përshkruese për instrumentin e përdorur tek mësuesit në nivel kombëtar, ku përfshihet numri i kampionit, minimumi i deklarimeve për secilin pohim, maksimumi i deklarimeve për secilin pohim, mesatarja e secilit pohim, devijimi standard dhe luhatjet e Alpha së Cronbach nëse secili pohim fshihet. Për të parë se kush janë pohimet më nivelin më të lartë apo me nivelin më të ulët për instrumentin e mësuesve është bërë paraqitja grafike e mesatareve të tyre (grafiku 5). Nga informacioni i marrë nga grafiku 4, shohim se pohimi me mesataren më të lartë është pohimi "Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit" me një mesatare 4,6 ndërkohë që mesatarja e pyetësorit në total është 4,09. **Nga kjo dalim në përfundimin se "ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit" perceptohet nga mësuesit si nga nga treguesit më pozitiv mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.** Nga grafiku vëmë re se vlerën më të ulët mesatare e ka pohimi "Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve", ku mund të themi se **duhet bërë më shumë për mbështetjen e mësuesve më materiale burimore të mësuesve të të gjitha lëndëve.**



Grafiku 5. Vlerat mesatare për secilin pohim

4.2 Analiza për çdo pohim në shkallë kombëtare dhe në nivel DAR-i

4.2.1 Pohimi: Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme

Paraqitja grafike 6 na jep rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të mësuesve për pohimin "Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme.". Këto gjetje tregojnë se 45,72% e mësuesve shprehen dakord, zgjedhje e cila është edhe alternativa që zë peshën më të madhe për këtë pohim. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e kampionit shprehet plotësisht dakord (35,05%) se kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme. Në vlera të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (10,31%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga mësuesit që janë shprehur pjesërisht dakord (7,4%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për mësuesit të cilët janë aspak dakord (1.4%), dhe ata të cilët nuk janë përgjigjur.

Informacioni i dhënë në grafikun 7 tregon numrin e DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar i cili është 7, përkatësisht DAR-et: Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Lezhë dhe Tirana Qark. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Berat me 4,37, ku vlera mesatare në nivel kombëtarëështë 4,05. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 6,ku përmendim DAR-et: Dibër, Durrës, Kukës, Shkodër, Tirana Qytet dhe Vlorë.

Grafiku 8 paraqet rezultatet për pohimin "Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit



Grafiku 6. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Kurrikulae re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme"

për të zgjidhur situata të jetës së përditshme". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Berat, Fier, Elbasan. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Vlorë.



Grafiku 7. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme"



Grafiku 8. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme"

4.2.2 Pohimi: Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve

2	**Dibër**	450	11,00	40,00	31,1600	6,08486
3	**Durrës**	291	11	40	34,4777	4,85323
4	**Elbasan**	702	10,00	40,00	32,9972	4,88089
5	**Fier**	1044	9,00	40,00	34,2174	5,33532
6	**Gjirokastër**	681	8,00	40,00	32,4068	5,27875
7	**Korçë**	539	17,00	40,00	32,6865	5,03852
8	**Kukës**	577	11,00	40,00	33,0797	5,01046
9	**Lezhë**	609	11,00	40,00	33,5238	4,96201
10	**Shkodër**	1140	8,00	40,00	33,0939	5,17057
11	**Tirana Qytet**	10657	8,00	40,00	31,9805	5,96757
12	**Tirana Qark**	739	13,00	40,00	33,3924	4,94608
13	**Vlorë**	798	10,00	40,00	33,0464	5,40450

Tabela 5. Të dhënat përshkruese për çdo DAR



Grafiku 52. Mesatarja në nivel DAR-i për instrumentin e mësuesve në total

Tabela 6 përmban të dhënat përshkruese për instrumentin e përdorur tek prindërit në nivel kombëtar, ku përfshihet numri i kampionit, minimumi i deklarimeve për secilin pohim, maksimumi i deklarimeve për secilin pohim, mesatarja e secilit pohim, devijimi standard dhe luhatjet e Alpha së Cronbach nëse secili pohim fshihet. Për të parë se cilat janë pohimet më nivelin më të lartë apo me nivelin më të ulët për instrumentin e prindërve është bërë paraqitja grafike e mesatareve të tyre (grafiku 53). Nga informacioni i marrë nga grafiku 53, shohim se pohimi me mesataren më të lartë është pohimi "Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm" me një mesatare 4,36 ndërkohë që mesatarja e pyetësorit në total është 4,05. **Nga kjo dalim në përfundimin se "**pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm", **perceptohet nga mësuesit si nga treguesit** më pozitiv mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Nr.	Pohimi	N	Min.	Max.	Mesatarja	Devijimi Standard	Cronbach's Alpha nëse pohimi fshihet
1	Programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë	18968	0	5	3,93	1,066	,793
2	Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije	18932	0	5	3,78	1,075	,794
3	Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur	18891	0	5	3,90	1,071	,801
4	Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim	18923	0	5	4,25	1,066	,811
5	Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës	18947	0	5	4,18	1,080	,809
6	Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit	18908	0	5	4,11	1,041	,801
7	Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët	18910	0	5	3,94	1,167	,809
8	Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm	18893	0	5	4,36	,977	,813

Tabela 6. Të dhënat përshkruese për çdo pohim



Grafiku 53. Të dhënat përshkruese për çdo pohim

5.2 Analiza për çdo pohim në shkallë kombëtare dhe në nivel DAR-i

5.2.1 Pohimi: Programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë.

Paraqitja grafike 54 na jep rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë". Këto gjetje tregojnë se 39,04% e prindërve shprehen dakord, zgjedhje e cila është edhe alternativa që zë peshën më të madhe për këtë pohim. Gjithashtu numër i madh i kampionit shprehet plotësisht dakord (34,77%) programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë. Në vlera të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (12,63%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindit që janë shprehur pjesërisht dakord (11,06%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindit të cilët janë aspak dakord (2,48%). Në vlera të papërfillshme është dhe kampioni i prindërve të cilët nuk janë përgjigjur.

Informacioni i dhënë në paraqitjen e mëposhtme (grafiku 55) tregon numrin e DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 10, ku janë përkatësisht DAR-et: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Beratme 4,17, ku vlera mesatare në nivel kombëtarë është 3,93. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 3,ku përmendim DAR-et: Dibër, Korçë dhe Tirana Qytet.

Grafiku 56 paraqet rezultatet për pohimin "Programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Berat, Fier, Elbasan. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Vlorë.



Grafiku 54. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë"



Grafiku 55. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë"



Grafiku 56. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë"

5.2.2 Pohimi: Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije

Informacioni i treguar në paraqitjen grafike 57 na jep rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije". Këto gjetje tregojnë se 39,08% e prindërve shprehen dakord, zgjedhje e cila është edhe zgjedhja që zë masën më të madhe për këtë pohim. Gjithashtu një numër tepër i lartë i kampionit shprehet plotësisht dakord (28,53%) se kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije. Në vlera pak më të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (17,60%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (11,86%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (2,90%) dhe ata të cilët nuk janë përgjigjur të cilët zënë një përqindje të pa konsiderueshme të kampionit të matur.

Informacioni i dhënë në grafikun 58 tregon numrin e DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar icili është 8, ku janë përkatësisht DAR-et: Durrës, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Durrës me 4,02, ku vlera mesatare në nivel kombëtarë është 3,78. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 5,ku përmendim DAR-et: Berat, Dibër, Elbasan, Fier dhe Tirana Qytet.

Grafiku 59 paraqet rezultatet për pohimin "Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Durrës dhe Fier. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Elbasan. Po ashtu shohim se DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit dakord janë DAR-et: Berat, Gjirokastër dhe Shkodër. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit dakord janë DAR Dibër dhe DAR Vlorë.



Grafiku 57. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Kurrikula e re i përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije"



Grafiku 58. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Kurrikula e re i përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije"



Grafiku 59. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Kurrikula e re i përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije"

5.2.3 Pohimi: Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur

Rezultatet në grafikun 60 janë rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur". Këto gjetje tregojnë se 36,12% e prindërve shprehen dakord, zgjedhje e cila është edhe alternativa që zë peshën më të madhe për këtë pohim. Gjithashtu në vlera të ngjashme është edhe pjesa e kampionit që shprehet plotësisht dakord (34,57%) se kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur. Në vlera relativisht të larta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (17,34%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (8,86%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (3.06%). Në vlera të papërfillshme është kampioni i cili nuk është përgjigjur.

Numri i DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 9 (grafiku 61), si p.sh.,DAR-et: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Lezhë me 4.39 dhe vlerën më të ulët mesatare e ka DAR Dibër me 3,73, ndërkohë që mesatarja në nivel kombëtar është 3.95. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 4, ku përmendim DAR-et: Berat, Dibër, Gjirokastër dhe Tirana Qytet.

Grafiku 62 paraqet rezultatet për pohimin "Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Durrës dhe Fier. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Korçë. Po ashtu shohim se DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit dakord janë DAR-et: Korçë dhe Kukës. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit dakord janë DAR Berat dhe DAR Tirana Qytet.



Grafiku 60. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur"



Grafiku 61. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur



Grafiku 62. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur"

5.2.4 Pohimi: Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim

Paraqitja grafike 63 na jep rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim". Këto gjetje tregojnë se më shumë se gjysma e kampionit, përkatësit 55,13 % e prindërve shprehen plotësisht dakord se "Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim". Gjithashtu një pjesë shumë e konsiderueshme e kampionit shprehet dakord (27,55%) se shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim. Në vlera relativisht të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (7,72%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (5,98%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (3,59%). Kampioni i cili nuk është përgjigjur është vlera shumë të ulëta, thuajse të papërfillshme.

Në paraqitjen grafike të mëposhtme shohim se numri i DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 8 (grafiku 64), si p.sh.,DAR-et: Durrës, Elbasan, Fier, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Durrës me 4,69, dhe vlerën më të ulët mesatare e ka DAR Dibër me 4,12, ndërkohë që mesatarja në nivel kombëtar është 4,25. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 4, ku përmendim DAR-et: Berat, Dibër, Korçë dhe Tirana Qytet. Ndërsa DAR Gjirokastër ka një vlerë mesatare të barabartë me vlerën kombëtare mesatare.

Grafiku 65 paraqet rezultatet për pohimin "Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Durrës dhe Fier. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Berat dhe DAR Tirana Qytet.



Grafiku 63. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Shkolla dhe mësuesit iu kanë informuar për reformat në arsim"



Grafiku 64. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Shkolla dhe mësuesit iu kanë informuar për reformat në arsim"



Grafiku 65. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Shkolla dhe mësuesit iu kanë informuar për reformat në arsim"

5.2.5 Pohimi: Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës.

Rezultatet në grafikun 66 janë rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës". Këto gjetje tregojnë se më shumë se gjysma e kampionit, përkatësit 51,24% e prindërve shprehen plotësisht dakord se Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës. Gjithashtu një pjesë shumë e konsiderueshme e kampionit shprehet dakord (29,70%) se "Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës". Në vlera relativisht të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (8,73%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (6,59%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (3,72%). Kampioni i cili nuk është përgjigjur është nëvlera shumë të ulëta, thuajse të papërfillshme.

Në paraqitjen grafike të mëposhtme shohim se numri i DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 11 (grafiku 67), si p.sh.,DAR-et: Berat, Dibër, Korçë, Durrës, Elbasan, Fier, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Durrës me 4,57 dhe vlerën më të ulët mesatare e ka DAR Tirana Qytet me 4,07, ndërkohë që mesatarja në nivel kombëtar është 4,18. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 2, ku përmendim DAR-et: Gjirokastër dhe Tirana Qytet. Ndërsa DAR Gjirokastër ka një vlerë mesatare të barabartë me vlerën kombëtare mesatare.

Grafiku 68 paraqet rezultatet për pohimin "Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Durrës dhe Fier. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Berat dhe DAR Tirana Qytet.



Grafiku 66. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës"



Grafiku 67. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës"



Grafiku 68. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës"

5.2.6 Pohimi: Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit

Informacioni i treguar në paraqitjen grafike 69 na jep rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit". Këto gjetje tregojnë se 44,60% e prindërve shprehen plotësisht dakord, zgjedhje e cila është edhe zgjedhja që zë masën më të madhe për këtë pohim nga totali i kampionit. Gjithashtu një numër tepër i lartë i kampionit shprehet dakord (34,82%) se tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit. Në vlera të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (10,10%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (7,90%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (2,58%), dhe ata të cilët nuk janë përgjigjur të cilët zënë një përqindje të pa konsiderueshme të kampionit të matur.

Informacioni i dhënë në grafikun 70 tregon numrin e DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar i cili është 6, ku janë përkatësisht DAR-et: Berat, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Tirana Qark. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Durrës me 4,28, ku vlera mesatare në nivel kombëtar është 4,11. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 6,ku përmendim DAR-et: Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastër dhe Tirana Qytet. DAR-i i Vlorës ka një vlerë mesatare me mesataren në nivel kombëtar.

Grafiku 71 paraqet rezultatet për pohimin "Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Berat dhe Fier. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Elbasan.



Grafiku 69. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit"



Grafiku 70. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit"



Grafiku 71. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit"

5.2.7 Pohimi: Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët

Paraqitja grafike 72 na jep rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët.". Këto gjetje tregojnë se 40,19% e prindërve shprehen plotësisht dakord, zgjedhje e cila është edhe alternativa që zë peshën më të madhe për këtë pohim. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e kampionit shprehet dakord (33,11%) se "Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët". Në vlera të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (11,878%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (9,8%). Në nivele të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (5,01%), dhe ata të cilët nuk janë përgjigjur zënë një përqindje prej 0,01%.

Informacioni i dhënë në grafikun 73 tregon numrin e DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar i cili është 8, ku janë përkatësisht DAR-et: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Berat me 4.16, ku vlera mesatare në nivel kombëtarë është 3,94. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 4,ku përmendim DAR-et: Dibër, Berat, Gjirokastër dhe Tirana Qytet. DAR-i Lezhë ka një mesatare të barabartë me mesataren në nivel kombëtar.

Grafiku 74 paraqet rezultatet për pohimin "Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Fier dhe Durrës. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Berat.



Grafiku 72. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët"



Grafiku 73. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët"



Grafiku 74. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët"

5.2.8 Pohimi: Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm

Rezultatet në grafikun 75 rezultatet në shkallë kombëtare të deklarimeve të kampionit të prindërve për pohimin "Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm". Këto gjetje tregojnë se 59,69 % e prindërve shprehen plotësisht dakord, zgjedhje e cila është edhe alternativa që zë peshën më të madhe për këtë pohim, më shumë se gjysma e kampionit. Gjithashtu një pjesë shumë e konsiderueshme e kampionit shprehet dakord (26,06%) se pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm. Në vlera të ulëta paraqitet edhe kampioni i cili është shfaqur neutral (7,12%) në lidhje me këtë pohim, pasuar nga prindërit që janë shprehur pjesërisht dakord (4,57%). Në nivele shumë të ulëta janë vlerat për prindërit të cilët janë aspak dakord (0,1%). Në vlera të papërfillshme është kampioni i cili nuk ka dhënë një përgjigje.

Numri i DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 8 (grafiku 74), si p.sh.,DAR-et: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Tirana Qark. Vlerën më të lartë të mesatares e ka arritur DAR-i Korçë me 4,56, ndërkohë që mesatarja në nivel kombëtar është 4,36. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 5, ku përmendim DAR-et: Berat, Dibër, Gjirokastër, Tirana Qytet dhe Vlorë.

Grafiku 76 paraqet rezultatet për pohimin "Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm". DAR-et me rezultate më të larta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR-et: Fier dhe Korçë. DAR-et me rezultate më të dobëta të deklarimit plotësisht dakord janë DAR Dibër dhe DAR Elbasan.



Grafiku 75. Rezultatet në shkallë kombëtare për pohimin "Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm"



Grafiku 76. Mesatarja në nivel DAR-i për pohimin "Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm"



Grafiku 77. Rezultatet në përqindje në nivel DAR-i për pohimin "Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm"

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Konkluzione

Rezultatet e përpunuara nga të dhënat e studimit dhe interpretimet e tyre tregojnë se:

- **73.1% e mësuesve** (37.5% janë plotësisht dakord dhe 35.68 dakord) pohojnë se kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve.
- **70% e mësuesve** (33.4 janë plotësisht dakord dhe 36.68% dakord) pohojnë se reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve.
- **74.8% e mësuesve** (32.59 janë plotësisht dakord dhe 42.26% dakord) shprehen se identifikimi i personalizuar i nevojave për trajnim i ka ndihmuar në orientimin personal për zhvillim profesional.
- **81.7% e mësuesve** (44.8% janë plotësisht dakord dhe 36.9% dakord) **pohojnë se si pasojë e reformës në arsimin parauniversitar shkolla është bërë më miqësore dhe gjithpërfshirëse për të gjithë.**
- **84% e mësuesve** (48.2 % janë plotësisht dakord dhe 36.2% dakord) besojnë se numri i ulët i alternativave të teksteve e ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre.
- **75.89% e mësuesve** (34.39% janë plotësisht dakord dhe 41.5% dakord) pohojnë se tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies.
- **71% e mësuesve** (37.6% janë plotësisht dakord dhe 33.4% dakord) shprehen se ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete
- **75.6% e mësuesve** (45.32% janë plotësisht dakord dhe 30.03% dakord) besojnë se portali i punësimit " Mësues për Shqipërinë" mundëson punësimin e bazuar në meritë e arritje.
- **84.7% e mësuesve** (43.81% janë plotësisht dakord dhe 40.9% dakord) shprehen se nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor.
- **85.9% e mësuesve** (53.6% janë plotësisht dakord dhe 32.3 % dakord) pohojnë se rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit.

Perceptimi i prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë është më pozitiv.

- **74.1% e prindërve** (34.7% janë plotësisht dakord dhe 39.4% dakord) besojnë se programet e reja mësimore i ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë.
- **70% e prindërve** (34.57% janë plotësisht dakord dhe 36.1% dakord) pohojnë se kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur.
- **82.6% e prindërve** (55.1% janë plotësisht dakord dhe 27.55% dakord) pohojnë se janë informuar nga mësuesit për reformat e ndërmarra në arsimin parauniversitar.
- **81% e prindërve** (51.24% janë plotësisht dakord dhe 29.7 % dakord) shprehen se shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës.
- **79.4% e prindërve** (44.6% janë plotësisht dakord dhe 34.8% dakord) pohojnë se tekstet mësimore u vijnë në ndihmë fëmijëve të tyre në procesin e të nxënit.
- **86.3% e prindërve** (59.9% janë plotësisht dakord dhe 26.6% dakord) pohojnë se pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm.

6.2 Rekomandime

Zbatimi i reformës në arsimin parauniversitar do të jetë një proces i gjatë i parashikuar deri ne vitin 2020. Kjo reformë do të synojë përmirësimin e cilësisë së të nxënit, në mënyrë që nxënësit të jenë të aftë të zgjidhin problemet komplekse të jetës së sotme, si në nivel personal ashtu edhe në nivel kombëtar e global.

Reforma e arsimit parauniversitar ka sjellë një konceptim të ri të kurrikulës që bazohet në kompetencat e të nxënit gjatë gjithës jetës, kërkon mësues të cilët, gjithnjë e më shumë, janë krijues, hartues, përzgjedhës të materialeve mësimore, bashkëpunues dhe të përgjegjshëm. Në këtë kuadër, një rol të veçantë merr zhvillimi profesional i mësuesve. Po ashtu një punë e vecantë duhet ti dedikohet dhe informimit të prindërve për cdo ndryshim që do të ndodhë në procesin mësimor dhe jetën në shkollë.

Rekomandimet që dalin nga ky raport MAS ja drejton të gjithë grupeve të interesit në nivel qendror, rajonal, në nivel shkolle, si dhe institucioneve të varësisë. E rëndësishme është që këto rekomandime të merren në konsideratë, sepse ato janë të zbatueshme dhe të efektshme për përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar.

Struktura e rekomandimeve është bazuar, kryesisht, në konkluzionet e këtij raporti.

- Perceptimi i mësuesve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar është pozitiv. DAR që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja kombetare e pohimeve janë DAR-et: Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Lezhë ,Tirana Qark, DAR Kukës, ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar janë DAR Durrës, Dibër, Shkodër, Tirana Qytet dhe Vlorë. Ky fakt tregon se ka ende shumë punë për të bërë me mësuesit e këtyre DAR për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me efektet pozitive që do të sjellë reforma në arsimin parauniversitar.
- Pohimi me mesataren më të lartë është pohimi “Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit” me një mesatare 4,6 ndërkohë që mesatarja e pyetësorit në total është 4,09. Kjo e dhënë tregon se reduktimi I numrit të nxënësve duke ndërtuar shkolla dhe mjedise të reja është domosdoshmëri për një zbatim më cilësor të reformës në arsimin parauniversitar
- Vlerën më të ulët mesatare e ka pohimi “Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve“. Rekomandohet që të vijohet një mbështetje më intensive në trajnimn e mësuesve në nivel lëndor për cdo DAR.
- **Perceptimi i prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë është më pozitiv.** Numri i DAR-eve që kanë mesatare më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar është 9 përkatësisht DAR-et: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tirana Qark dhe Vlorë. Ndërsa numri i DAR-eve që kanë mesatare më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është 4, ku përmendim DAR-et: Berat, Dibër, Gjirokastër dhe Tirana Qytet. Në këto DAR duhet të intesifikohet komunikimi me prindërit, ndërgjgjësimi I tyre në lidhje me efektet positive që sjell reforma në arsimin parauniversitar.

ANEKSET

7.1 ANEKSI 1

PYETËSOR PËR MËSUESIT

DAR/ZA: _____ **Shkolla:** _____

Gjinia:

☐ Femër
☐ Mashkull

Ju jepni mësim: **Klasa**

☐ në arsimin parashkollor _____
☐ në arsimin fillor _____
☐ në arsimin e mesëm të ulët _____
☐ në arsimin e mesëm të lartë _____

Fusha ku bën pjesë lënda që ju jepni mësim është: **Lënda**

☐ Gjuhët dhe komunikimi _____
☐ Matematika _____
☐ Shkencat e natyrës _____
☐ Shoqëria dhe mjedisi _____
☐ Teknologjia dhe TIK-u _____
☐ Arte _____
☐ Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti _____

Ju lutem, shënoni me X zgjedhjen tuaj në kutizën përkatëse. Nëse ju mendoni se është e nevojshme, mund të bëni komente në fund të pyetësorit.

Shkalla e vlerësimit

1. **Aspak dakord** **2. Pjesërisht dakord** **3. Neutral** **4. Dakord** **5. Plotësisht dakord**

NR.	FUSHA	VLERËSIMI				
		1	*2*	*3*	*4*	*5*
1	Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca e bën të nxënit më funksional duke i përgatitur nxënësit për të zgjidhur situata të jetës së përditshme.					
2	Fleksibiliteti në zbatim që krijojnë programet e reja mësimore mundëson përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve.					
3	Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka sjellë lehtësim të ngarkesës mësimore të nxënësve.					
4	Reforma kurrikulare është mbështetur me trajnime dhe materiale burimore për mësuesit e të gjitha lëndëve.					
5	Identifikimi i personalizuar i nevojave për secilin mësues ka lehtësuar orientimin e mësuesve për zhvillimin profesional të tyre.					
6	Ndryshimet e kryera në arsim e kanë bërë shkollën më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse.					
7	Numri i reduktuar i alternativave të teksteve mësimore ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së tyre.					
8	Tekstet e reja mësimore të kurrikulës së re kanë përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe të mësimdhënies.					
9	Ndryshimet në Maturën Shtetërore (shpallja e pragut kalues, administrimi i mirë dhe mesatarja mbi notën 6) kanë rritur transparencën e procesit dhe kanë siguruar prurje më cilësore për në universitete.					
10	Reformat e ndërmarra në drejtim të nismës “Shkolla qendër komunitare” kanë mundësuar partneritet më të mirë shkollë-familje- komunitet.					
11	Portali “Mësues për Shqipërinë” mundëson punësim të bazuar në meritë dhe në arritje.					
12	Ulja e normës mësimore dhe reduktimi i numrit të nxënësve në klasa lehtëson punën e mësuesit dhe procesin e të nxënit.					
13	Nxitja e integrimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie ka rritur cilësinë e procesit mësimor.					
14	Rikonceptimi i kurrikulës së sporteve ka rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin, kujdesin për të, si dhe për rolin e sportit.					
Komente:						

7.2 ANEKSI 2

PYETËSOR PËR PRINDËRIT

DAR/ZA: _____ **Shkolla:** _____

Gjinia:

☐ Femër
☐ Mashkull

Niveli i edukimit:

☐ Arsimi 8-vjeçar
☐ Arsimi mesëm
☐ Arsimi i lartë
☐ Tjetër: _____

Statusi i punësimit: **Profesioni**

☐ I punësuar _____
☐ I papunë _____

Ju lutem, shënoni me X zgjedhjen tuaj në kutizën përkatëse. Nëse ju mendoni se është e nevojshme, mund të bëni komente në fund të pyetësorit.

Shkalla e vlerësimit

1. Aspak dakord 2. Pjesërisht dakord 3. Neutral 4. Dakord 5. Plotësisht dakord

NR.	FUSHA	VLERËSIMI				
		1	*2*	*3*	*4*	*5*
1	Programet e reja mësimore u ofrojnë nxënësve më shumë mundësi për t'i përdorur njohuritë në praktikë.					
2	Kurrikula e re u përgjigjet veçorive individuale të të nxënit të çdo fëmije.					
3	Kurrikula e re mundëson zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur.					
4	Shkolla dhe mësuesit ju kanë informuar për reformat në arsim.					
5	Shkolla ka nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në veprimtaritë e shkollës.					
6	Tekstet mësimore u vijnë në ndihmë nxënësve në procesin e të nxënit.					
7	Infrastruktura shkollore krijon një mjedis të nxëni dhe miqësor për fëmijët.					
8	Pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm.					
Komente:						